

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

Shpresa / er-Rexhaa /

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ thotë:

"لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِي رَسُولِ اللَّهِ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ لِّمَن كَانَ يَرْجُو اللَّهَ وَالْيَوْمَ الْآخِرَ"

“Me të vërtetë, i Dërguari i Allahut është një shembull i shkëlqyer për këdo që var shpresën te Allahu dhe te Dita e Fundit.” (el-Ahzaab, 21)

Shpresa është shkalla më e dobët e ndjekësit të shtegut të pastrimit shpirtëror. Sepse, në njëfarë mënyre, shpresa është një përzierje në gjëra që s'të përkasin dhe një bërje e vërejtjes.¹ Kjo është pothuajse një pakujdesi.² Përrjashtim të vetëm bën dobia për të cilën ajo (shpresa) u përmend në Shpallje dhe në Sunet, dhe u përfshi në praktikën e njerëzve të mençur: dobia e ftohjes së nxehtësisë së frikës, në mënyrë që ajo (frika) të mos kalojë në dëshpërim.³ Shpresa ka tri nivele:

¹ Shpresa e pastër dhe e rekomandueshme nuk nënkupton as përzierje, as vërejtje. Të Dërguarit, shoqëruesit e tyre dhe ndjekësit e tyre vazhdimisht i kanë kërkuar Allahut favore si për këtë jetë, ashtu dhe për jetën tjetër. Duaja që pejgamberi ﷺ e konsideroi si thelbin e adhurimit e tëra ka të bëjë me shpresën. Kurani kërkon nga ne që të lutemi për mëshirën dhe bujarinë e Allahut. Po, dikujt mund t'i mungojë pajtimi me caktimet e Allahut dhe për të këtillet mund të thuhet se përzihen në vullnetin e Tij dhe i bëjnë vërejtje. Kjo nuk është shpresa që u lavdërua në Shpallje dhe që u praktikua nga besimtarët më të mëdhenj.

² Imam Ibn el-Kajjim përmend se arsyeja përse Imam el-Harawi mund të ketë gabuar në këtë pikë është dorëzimi i tij i lavdërueshëm ndaj caktimeve të Allahut, gjë që edhe mund ta ketë parandaluar nga të parët e anëve të tjera të kësaj çështjeje. Imam Ibn el-Kajjim këtu na mëson si të jemi të mirësjellshëm ndërsa kundërshtojmë kategorikisht dikë që mund ta quajmë “hoxha im” apo “hoxha i Islami”. Ai i kërkon falje Imam el-Harawit që iu desh ta kundërshtonte, por dhe thekson se e vërteta për të është më e dashur sesa Imam el-Harawi.

³ Shpresa ka edhe shumë dobi të tjera. Ajo nënkupton pasjen e mendimeve të mira për Allahun. Kjo ka të bëjë me përqafimin e cilësive të Tij të hijeshisë (*xhemaal*), si: falja, përdëllimi (dhembshuria), dhe bujaria. Kjo sjell robin te dyert e Tij dhe e mban aty. Ibn el-Kajjim përmend në el-Medaarixh edhe shumë dobi të tjera të shpresës.

Niveli i parë është një lloj shprese që:

- Josh vepruesin për t'u shquar
- Shkakton kënaqjen në shërbim (adhurim)
- Zgjon natyrën që të përmbahet lehtësisht nga ndalimet

Niveli i dytë është shpresa e praktikuesve të ushtrimit shpirtëror në arritjen e një pozite ku dëliret nijeti i tyre. Kjo ndodh:

- Duke refuzuar kënaqësitë (e dynjasë)
- Duke përmbushur kërkesat e dijes⁴
- Duke u shquar në vetëpërbajtje

Niveli i tretë është shpresa atyre që kanë zemër të pastër, që është shpresa për ta takuar të Vërtetin (i lartësuar qoftë!) e cila:

- Ngjall mall
- Prish kënaqësitë e jetës⁵
- Shkakton mosinteresim për krijesat⁶

⁴ Përshtatja me sheriatin duke kërkuar dijen dhe duke vepruar sipas saj.

⁵ Ty nuk të pëlqen sesi kënaqësitë e jetës pengojnë arritjen e synimit tënd.

⁶ Sepse ti nuk ke nevojë më për ta. Po ashtu ti sheh se ata pengojnë arritjen e synimit që ke. Sidoqoftë, ata prej tyre që të ndihmojnë gjatë udhëtimit (drejt Allahut), janë dhuratë nga Allahu, për çka ti duhet të tregohesh mirënjohës.